

## Mjete për ta përfitur burrin

*Këto më poshtë janë mjete të rëndësishme për të përfitur burrin, mirëpo kurrë mos harro se mjeti më i rëndësishëm është frika prej Allahut [subhanehu ve tealja].*

- 1- Telefonoi nëse vonohet në punë dhe interesohu për te.
- 2- Lavdëroi gjërat që i blenë ai.
- 3- Përgatite ushqimin që i pëlqen.
- 4- Ndëroja vendin mobiljeve në shtëpi herë pas here.
- 5- Bën kuiz mes anëtarëve të familjes pas namazit të sabahut.
- 6- Përkujtoja punët në mëngjes.
- 7- Participo në brenqat e tij dhe konsultim.
- 8- Parfymose herë pas here, sidomos ditën e xhuma.
- 9- Bëhu e loqjikshme në kërke-

## Dëmet e mëkateve

Mëkatet lënë gjurmë të këqija dhe të urrejtura në zemër, në trup, në dunja dhe në ahiret, të cilat vetëm All-llahu [subhanehu ve tealja] i di. Prej tyre janë edhe këto:

- a) **Të privon nga dituria**, sepse dituria është dritë të cilën All-llahu [subhanehu ve tealja] e futi në zemër, kurse mëkati e fikë këtë dritë.
- b) **Të privon nga rizku**, sepse Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: "Robi privohet nga rizku me mëkatin të cilin e bën". (Ahmedi, hadithi është sahih).
- c) **Vetmia**, të cilën e ndien mëkatarin në zemrën e tij, me të cilën nuk ndien asnjë kënaqësi.
- d) **Errësirë** e cila ia kaplon zemrën... realisht e ndien ashtu siç e ndien errësirën e natës.
- e) **Privohet nga adhurimi**.
- f) Mëkatet e **zvogëlojnë jetën** dhe e **largojnë bereqetin**.
- g) **Mëkatet lindin mëkate**... disa dijetarë të selefit kanë thënë: dënimi i një mëkati është mëkati që vijon, kurse shpërbllimi i një të mire është e mira tjetër që pason.
- h) Vazhdon njeri të bëjë mëkate derisa **i duken të vogla dhe pa vlerë**... kjo është shenjë e shkatërrimit.
- i) **Mëkati shkakton mposhtje**, sepse e tërë krenaria është në respekt ndaj All-llahut [subhanehu ve tealja].
- j) **Mëkatet e prishin edhe mendjen**, sepse logjika është dritë, kurse mëkatet e fikin atë dritë.
- k) Nëse i mblidhen njeriut mëkatet, **i vulozet zemra** e bëhet nga të paludesshmit. Këtë e kanë thënë disa dijetarë e parë të devotshëm duke e pasur për bazë ajetin Kur'anor: "Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që i punuan, zemrat e tyre ua mbuluan". (El-Mutaffirin: 14).
- l) **Të privon nga lutja e Pejgamberit** [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe nga **lutja e melekeve**. Sepse All-llahu [sub-

## Pesë mënyra origjinale për zbulimin tënd

### 1. Për të pasur lëkurë të lëmuar

Bëje që dashuria të jetë ampëri juaj kryesor në çdo veprim me familjen tënde. Largoju mërgjitëve dhe ji optimiste, pranoje të vertetën me zemër të mirë që të ruash shkëlqimin e lëkurës tërë jetën, me lejen e All-llahut të Madhëruar.

### 2. Për të pasur sy të shkëlqyer

Shiko me një shikim të ëmbël tek shoqëuesi i jetës tënde, tek i dashuri yt, përqëndroje shikimin e mbushur plot dashuri tek sytë e tij, me qëllim që të arrijë në zemrën e tij, në qendrën e ndikimit kryesor e cila e përcjell atë për në zemrën tënde sikur një rrejt elektrik, dhe zema e tij i përgjigjet syve të tu

-përsërite vazhdimisht këtë ushtrim profetik të nderuar: (Me të vertetë nëse burri shikon tek gruaja e tij dhe ajo shikon tek ai, i shikon ata All-llahu [subhanehu ve tealja] në rast se kap dorën e saj u bien mëkatet e tyre ndërmjet gishtërinjëve) përsërite këtë ushtrim të pakten dy herë në ditë një herë para se të shkojë për në punë dhe një herë tjetër kur të kthehet nga puna.

### 3. Për të pasur buzë të bukura

Përdor gjithmonë fjalët të mira, të kuptueshme dhe plot dashuri, ulë zërin tend, mundohu të jesh sa më afër në momentin kur bisedon me te. Fjalët e tua në këtë mënyrë kanë një ndikim të qulltishëm tek ai, fjalët të cilat dalin prej dy buzëve të buku-

## Tridhjetë shenjat e hipokritëve

1. Janë falls në thëniet e tyre dhe gënjejnë.
2. Tradhetojnë.
3. Tregojnë mosbindje dhe dëshirojnë të debatojnë.
4. Thyejnë premtimin.
5. Janë dembel në adhurim.
6. I bëjnë veprat për tu dukur.
7. I mungon të përkujtuarit e fesë.
8. Nguten në falje.
9. Shajnë ata të cilët bëjnë vepra të mira nga besimtarët dhe të drejtët.
10. Tallen me Kur'anin, sunnetin dhe të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem].
11. Bëjnë betime për t'u mbrojtur.
12. Urrejnë të shpenzojnë diç për hir të All-llahut [subhanehu ve tealja].
13. Dezertojnë dhe i lëjnë në baltë muslimanët.
14. Krijojnë zhurma false duke bërë fitne.
15. Gjejnë gabime në vendimet e All-llahut [subhanehu ve tealja].
16. Çnderojnë të drejtët.
17. Qëndrojnë larg nga namazet me xhemat.
18. Shkaktojnë çrregullime ndërsa thonë

## Për ty... margaritari i shoqërisë

Motër muslimane, dije se gurët e çmura zëvendësohen nëse vidhen, humben ose thehen... përveç teje!

Pra kush është ajo që mund ta zëvendësojë gruan muslimane, të famshme, të dëlirë?! Motër muslimane! Ki frikë All-llahun [subhanehu ve tealja]!

Sot punon e nuk llogaritesh, kurse nesër llogaritesh e nuk do të mund të punosh.

Dije se njeriu e humb kohën në zbatimet dhe lojë deri sa t'i vijë vdekja e vetëm atëherë e kupton. Si do të jetë halli me ty o robërshë e All-llahut, kur të vijë shpirti në fyt, kur të puqet (mbështillet) brinja me brinjë e kur të largohesh nga bashkëshorti dhe familja, nga bijtë dhe të afërmit? Si do të jetë halli yt kur të gjendesh në arkivol e kur të mbajnë në kraharor e të mbulohesh me dhe, e të ndodhesh në errësirën dhe ngushticën e varrit? Si do të jetë halli yt kur të vijnë meleket Munker dhe Nekir e të pyesin?

Çdo të ndodhë me ty kur të dalësh nga varri në ditën kur do të ringjallen krijesat e të shpërndahen?

Si do të jetë me ty kur të fluturojnë fletushkat, të shtrohet sirati e të vendoset mizani (peshoja)? All-llah, All-llah! Oj robërshë e All-llahut! Ky është qëllimi.

All-llahu i Lartësuar thotë:

**„E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: „O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova! Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që**

## Mënyra për forcimin e memories

Të harruarit është nga natyra e njeriut, siç një ka thënë poet arab:

Është quajtur njeri (insane) për shkak të harrësës së tij (nasijan)

Është quajtur zemër (el-kalb) për shkak se ndryshon vazhdimisht (jatakaleb).

Në të kaluarën kanë thënë se i pari që harroi ishte njeriu i parë, duke aluduar në Ademin [alejhi selam]. Harresa është diçka që ndryshon nga një person tek një person tjetër sipas natyrës së çdo individi, disa mund të harrojnë më shumë sesa të tjerët. Ja disa gjëra që mund të ndihmojnë për të luftuar harrësën janë si më poshtë:

1. **Largimi nga mëkatet** për shkak se efektet e këqija të mëkateve rezultojnë me një memorie të dobët dhe me paafësi për të përfitur dituri. Errësira e mëkati nuk mund të ekzistojë me dritën e dijes. Fjalët e mëposhtme janë atribuar Imam Shaf'it [rahimehullah]:

"Unë u ankova tek (shejhu im) Uaki rreth memories së dobët dhe ai më tregoi mua që unë duhet të qëndroj larg nga mëkatet. Ai ka thënë që dituria si dritë e All-llahut [subhanehu ve tealja], e drita e Allahut nuk i jepet një mëkatarin".

El-Katibi ka transmetuar në el-Xhami (2/387) që Jahja Ibën Jahja ka thënë: Një njeri e pyeti Malik Ibën Abbasin: „Ebu Abdullah! A ka ndonjë gjë që do të përmirësojë memorien time? "Ai iu përgjigj: „Nëse ndonjë gjë që do ta përmirësojë është lënia e gjynaheve".

Kur një person kryen një mëkat e përfshin atë dhe kjo çon në ankth dhe trishtim që të mban të zënë duke menduar rreth asaj se çfarë ai ka bërë. Kjo i dobëson senset e tij dhe e habit atë nga shumë gjëra të dobishme përfshirë edhe nga kërkimi i dijes.

ra të zbuluara me turp dhe me butësi.

**4. Për të pasur durë dhe gishtet t'j të butë dhe si të mbrojtur ato nga ashpërsimi?**

Në rast se ndodh ndërmjet jush ndonjë mosmarrëveshje çohu dhe gëzo këto ushtrimet profetike. (A doni tju tregoj juve për cilësitë e grave të Xhenetit, çdo grua e sjellsme dhe veçud [ato që lindin fëmijë shumë] në rast se nevrikoset ose burri i saj silltet keq me te, ose ka kundërshtuar udhëtarin e tij, thotë: Kjo është dora ime tek dora jote dhe unë nuk do ta largoj ate prej këtu derisa ti të jesh i kënaqur prej meje)

Dhe së fundi..

**5. Veshët e tu**

Qe të jesh zonja e një veshi edukues; përdore veshin tënd të mprehtë i cili i përngjigjet vetëm të mirës, përgjon vetëm të mirë dhe gjëra të dobishme, shurdhoje apo mbyllle ate në drejtim të të dëgjuarit të thashethemeve apo çdo të keqeje dhe të shëmtuare.

Mëso stilin e të dëgjuarit dhe të mos dëgjuarit, dhe përqëndrohu me bashkëshortin tënd mirë, ji dëgjuese e mirë kur ai të flet për gjërat që i interesojnë dhe punën e tij, sepse ne kemi dy veshë e vetëm një gojë.

Përktheu F.Gurra.

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup



hanehu ve tealja] e ka urdhëruar Pejgamberin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] të kërkon falje për besimtarët dhe besimtarët:

„Ndërsa ata (engjëjt) që e bartin Arshin dhe ata që janë përreth tij, larësojnë me falënderim Zotin e tyre, i besojnë Atij dhe i luten Atij t'i falë ata që besuan (duke thënë): „Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe me diturinë Tënde ke përfshirë çdo send, andaj falu atyre që u penduan dhe ndoqën rrugën tënde, e edhe ruaj ata nga dënimi i Xhehennemit!“. (Gafir: 7).

m) E dobëson zemrën nga vullneti i saj... atëherë forcohet vullneti i mëkatit, kurse njëkohësisht vonohet dëshira për pendim, derisa të largohet tërësisht dëshira për teube (pendim) nga zemra e këtij njeriut.

n) Është shkak që mos të ketë vlerë ky njeri të All-llahu [subhanehu ve tealja]. All-llahu [subhanehu ve tealja] thotë:

“Atë që e poshtëron All-llahu nuk ka kush që mund ta bëjë të ndershëm”. (el-Haxhxh: 18).

o) Mëkatet e fusin njeriun nën mallkimin e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], sepse ai i ka mallkuar shumë mëkate, kurse ai që i bënë ato mëkate e meriton atë mallkim.

p) Largohet nga zemra e tij konsiderimi i mëkateve gjëra të këqija, atëherë bëhen adete dhe nuk i pengojnë fjalët e nejrëzve e as shikimi i tyre. Bile kjo të mëkatarët është kulmi i kënaqësisë, saqë ata edhe krenohen me mëkate, për të cilët Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

“I gjithë ummeti im është i falur; përveç atyreve që i publikojnë mëkatet...” (Buhariu).

Shqipëroi: Bekir Halimi

Marrë nga libri “Xhebabul-Kafi”, fq. 57.

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup



sat tuaja dhe kujto fjalën e urtë: “Gruaja vetëm burrin e dëshiron, e kur ta arrijë burrin, i dëshiron të gjitha gjërat”.

10- Mundohu të mësosh gjëra të reja në kuzhinë, në përgatitje të ushqimeve, në art, që të sheh burri yt te ti gjëra të reja.

11- Duhet ngjallur nocionin: “Ne nuk ndahemi për dunja”, për këtë nuk duhet undërshtuar gjatë emërtimit të ndonjë fëmije ose blerjes së ndonjë mobiljeje ose përgatitjes së ndonjë ushqimi.

12- Ndërrimi i pamjes herë pas here, duke i rregulluar flokët në mënyra të ndryshme ose duke përdorur mikiazh ose gjëra tjera, nëse burrit i pëlqen një gjë e tillë.

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup



2. Përkujtimi i All-llahut [subhanehu ve tealja] vazhdimisht duke bërë dhikër, tesbih (dukë thënë subhanAllah), tehmid (El-Hamdulillah), tehlil (la ilahe il-lallah) dhe tekbir (Allahu ekber) etj... All-llahu [subhanehu ve tealja] ka thënë: „E kur të harrosh, përmende Zotin tënd“. (El Kehf: 24).

3. Mosngrënia shumë, për shkak se ngrënia shumë e bën një person të fle shumë dhe e bën dembel dhe ia dobëson senset, dhe përveç kësaj e ekspozon ate ndaj rrezikut të sëmundjeve fizike. Pjesa më e madhe e sëmundjeve siç ne shohim rezultojnë nga ushqimi dhe pija.

4. Disa dijetarë kanë përmendur disa ushqime të cilat mund të ngrëjnë memorien të tilla si ngrënia e mjaltit dhe ngrënia e rrushit të thatë etj.

Imam el-Zuhri ka thënë: „Ju duhet të hani mjalte për shkak të mirësisë së saj për memorien“. Ai gjithashtu ka thënë: „Kush do që dëshiron të memorizojë hadithin duhet të hajë rrush të thatë“.

Ibrahimi ka thënë: „Ju duhet të përtypni për shkak se (kjo) jep energji zemrës dhe largon harresën“.

Si dhe ata përmendin shumë ushqime që përmbajnë acide e janë shkak i dembelizimit dhe memories së dobët.

5. Një tjetër gjë që mund të ndihmojë memorien dhe për të reduktuar harresën është hixhama e kokës ashtu siç është e ditur nga eksperiencia. (Për më tepër informim shih librin Mjekësia e të dërguarit, Gjakovë, 2002).

Përktheu: Ammar Ardit Kraja  
Marrë nga: <http://www.albislam.com>

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup



e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distance peridodike) deri ne ditën kur ringjallen.” (El-Mu'minun 99-100)

Oj besimtare - thesar i mirësisë! Ki kujdes prej:  
- Talljes me çështjet e fesë;  
- Shpikjeve në fe - bidateve (risive);  
- Vonesës apo lënien e namazeve;  
- Zbulimit të gjymtyrëve.  
- Gibetit (përgojimit) dhe nemimitit (bartjes së fjalëve).

- Por edhe lmitimit të jobesimtarëve, që assesi mos të lind te ti lakmia ndaj tyre;

- Daljes së tepërt pa nevojë,  
- Harresës së Ahiretit,  
- Mosrespektimit të burrit dhe mosrespektimit të prindërve.

Motër muslimane! Përmbaju:

-Tevhidit (besimit në All-llahun) dhe pasimit të sunetit të të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve selem].

- Shoqërimit me shoqe që i përmbahen fesë së All-llahut [subhanehu ve tealja],

- Duasë (lutjes) dhe të drejtuarit kah All-llahu [subhanehu ve tealja] me kërkimin e faljes se mëkateve;

- Përgatitjes për Ditën e Gjykimit.

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup



se duan të vendosin paqen.

19. Sjellja e jashtme e tyre është në kontradiktë me atë që kanë në zemër.

20. I frikësohen ngjarjeve të pakëndshme, incidenteve dhe ngjarjeve.

21. Përdorim shfajsime fallse.

22. Urdhërojnë për kah e keqja dhe pengojnë nga e mira.

23. Janë dorështrënguar.

24. E harrojnë All-llahun [subhanehu ve tealja].

25. Mohojnë premtimin e All-llahut [subhanehu ve tealja] dhe të dërguarit të tij [sal-lall-llahu alejhi ve selem].

26. Shqetësohen për pamjen e jashtme dhe neglizhojnë të brendshmen.

27. Janë eloquent, oratorë, mbajnë ligjëratë të gjata etj..

28. Ju mungon të kuptuarit e fesë.

29. Nuk bëjnë mëkate para syve të njerëzve, por tregohen të vyeshtëm në kryerjen fshehurazi të gjynaheve.

30. Gëzohen për ndonjë fatkeqësi që bie ndër besimtarë dhe trishtohen kur ata gëzojnë dhe kënaqen.

Aid Abdullah el-Karni  
Përktheu: (Ammar) Ardit Kraja

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor  
Rr. Stiv Naumov 7 / 18  
Tel. ++389 (02) 32 23-654  
1000, Shkup

